



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ SKENDERAJ
Nr.
No. <u>02-060/01-000034024</u>
Data.
Data. <u>03.01.2024</u>



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra për informim

Data/Date:	03.01.2024
Nga/Od/From	Jeton Rushiti, zyrtar përgjegjës për koordinim të procesit të konsultimit publik
Për/Za/To:	Fadil Nura, kryetar i Komunës
Tema/Subjekat/Subject	Raporti për takimin e dytë të Kryetarit të Komunës me qytetarë, i mbajtur më 22 dhjetor 2023, në Sallën e Kuvendit Komunal

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna.


Në kuadër të përmbushjes së obligimit ligjor, përkatësisht në respektim të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, Fadil Nura, më 22 dhjetor 2023, nga ora 14:00, ka mbajtur takimin e dytë me publikun, në sallën e Kuvendit Komunal të Skenderajt, ku kanë marrë pjesë 20 qytetarë, të moshës nga 25 deri në 65 vjeç. Në aspektin e ndarjes gjinore, nga ky numër i pjesëmarrësve, 11 kanë qenë femra dhe 9 meshkuj.

Paraprakisht janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sa i takon informimit të qytetarëve për këtë takim. Me datë 8 dhjetor qershor është publikuar në faqe të Komunës në internet dhe në llogarinë zyrtare në facebook njoftimi i protokolluar. Edhe në forma tjera të komunikimit me qytetarë, grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile, janë bërë njoftimet për këtë takim.

Në prezantimin e tij, kryetari i Komunës, i ka njoftuar të pranishmit me punën e pjesës së dytë të vitit, përkatësisht të periudhës qershor – dhjetor 2023, nga ana e Ekzekutivit në Skenderaj, me projektet që kanë nisur të realizohen dhe me planet përgjatë këtij viti.

Në këtë takim, ku është mbajtur edhe procesverbali, me regjistrim të kërkesave nga ana e qytetarëve, përveç rezymesë nga ana e kryetarit Nura, qytetarët kanë parashtruar kërkesa për projekte të ujësjellësit dhe investime në infrastrukturën rrugore publike.

Të gjitha kërkesat janë evidentuar në procesverbalin zyrtar të takimit me publikun.



Linku i njoftimit i publikuar nw webfaqen e Komunws:

<https://kk.rks-gov.net/skenderaj/wp-content/uploads/sites/27/2023/12/Njoftim-per-publikun.pdf>

Lajmi i publikuar në faqen e Komunës në internet:

<https://kk.rks-gov.net/skenderaj/news/kryetari-nura-mban-edhe-takimin-e-dyte-vjetor-me-qytetare/>

Linqet e njoftimit publik për takimin

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=748620770626642&set=a.294560692699321>

Raportin e përgatiti:

Jeton Rushiti, zyrtar për Informim Publik



The image shows a handwritten signature in blue ink on the left, and a circular official stamp on the right. The stamp is blue and contains the following text: 'REPUBLIKA E KOSOVË' at the top, 'KOMUNA E SKENDERAJ' in the middle, 'KRYETARI I KOMUNES' at the bottom, and 'MUNICIPALITY OF SKENDERAJ' on the right side. In the center of the stamp is a map of Kosovo with a star above it.